



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 mars 2022
Nr. ref.:RK 1968/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI98/21

Parashtrues

Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës
për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
nr. AC-I-18-0026, të 14 janarit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), me vendbanim në Prishtinë, të cilët i përfaqëson Saranda Keqekolla-Sadiku, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin AC-I-18-0026, të 14 janarit 2021 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DhPGJS-së), për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP). Aktvendimi i kontestuar u është dorëzuar parashtrueseve të kërkesës më 18 janar 2021.
3. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), rikujton se shkresat e lëndës së kësaj kërkesë flasin për një paluajtshmëri e evidentuar në librat kadastral me numër 1743-0, në sipërfaqe prej 2.88,29 hektarë, e cila ndodhet në zonën e quajtur “Veternik” në Prishtinë. Kjo paluajtshmëri ishte objekt i shqyrtimit në Gjykatë në rastin e saj KI231/19, me parashtrues AKP-në. Kjo e fundit, nëpërmjet kërkesës KI231/19, pretendonte të drejtën e pronësisë mbi 6 (gjashtë) paluajtshmëri, respektivisht në ngastrat: nr. 1740, në sipërfaqe prej 0.24,41 ha; nr. 1741 në sipërfaqe prej 0.78,03 ha; nr. 1742 në sipërfaqe prej 0.78,03 ha; nr. 1743 në sipërfaqe prej 2.88,29 ha; nr. 1744 në sipërfaqe prej 0.32,72 ha; nr. 1745 në sipërfaqe prej 0.80,68 ha; nr. 1899 në sipërfaqe prej 3.56,71 ha, të gjitha me sipërfaqe të përgjithshme prej 9.76,27 ha, të ndodhura në vendin e quajtur “Veternik” në Prishtinë. Në lidhje me këto paluajtshmëri Kolegji i Apelit i DhPGJS-së, me Aktgjykimin [AC-I-15-0212-A0001], kishte konstatuar se e drejta e pronësisë i takonte paraardhësve të Z. H., tashmë e ndjerë.
4. Për më tepër, Gjykata vëren se njëra nga paluajtshmëritë kontestuese ishte objekt i shqyrtimit, në rastin KI106/21, e cila është parashtruar në Gjykatë, më 28 maj 2021 nga disa parashtrues të tjerë, të cilët pretendonin titullin e pronësisë përkitazi me ngastrën kadastrale nr. 1742, në sipërfaqe prej 0.78,03 ha, e ndodhur në vendin e quajtur “Veternik” në Prishtinë.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, nëpërmjet të cilit parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 7 [Barazia para Ligjit] të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNj) dhe nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-21 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 18 maj 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën, nëpërmjet postës, të cilën Gjykata e pranoi më 20 maj 2021.
8. Më 4 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 14 qershor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, u njoftuan gjithashtu DhPGjS-ja dhe AKP-ja.
10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 12 nëntor 2021, Gjykata nga Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, kërkoi informata shtesë në lidhje me paluajtshmërinë kontestuese.
12. Më 19 nëntor 2021, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Prishtinës e dorëzoi në Gjykatë një varg dokumentesh, duke përfshirë përshkrimin e historikut përkitazi me paluajtshmërinë kontestuese.
13. Më 2 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi shtyrjen e vendimmarrjes së rastit për një seancë të radhës shqyrtuese.
14. Më 3 mars 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën qartazi të pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve të rastit

15. Kërkesa ka të bëjë me një kontest pronësor, përkatësisht me paluajtshmërinë nr. 1743, në sipërfaqe prej 2.88,09 hektarë, e cila ndodhet në vendin e quajtur "Veternik" në Prishtinë. Sipas parashtruesve të kërkesës, paluajtshmëria në fjalë ishte blerë në vitin 1938 me marrëveshje mes L. Z. dhe paraardhësit të parashtruesve të kërkesës S. S. D.
16. Më 2 dhjetor 2010, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në DhPGjS kundër AKP-së, si administratore e pronave shoqërore dhe kooperativës bujqësore KBI "Export-Imort" në Fushë-Kosovë. Nëpërmjet kësaj padie, parashtruesit e kërkesës kërkuan njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese me nr. 1743, duke pretenduar se janë pasardhës të S.S.D., dhe se paluajtshmëria në fjalë u takon atyre.

17. Më 27 mars 2012, DhPGjS një kopje të padisë ia dërgoi AKP-së, si palë e paditur në këtë procedurë, e cila më 17 prill 2012, parashtrori përgjigje në padi, duke arsyetuar se AKP-së i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë e paditur në këtë procedurë. Për më tepër, AKP pretendoi se paluajtshmëria në fjalë nuk ishte e regjistruar asnjëherë në emër të paraardhësve të parashtruesve të kërkesës.
18. Më 7 dhjetor 2016, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, në mënyrë të rregullt ftoi palët ndërgjyqëse që, më 17 janar 2017, të marrin pjesë në seancë dëgjimore.
19. Më 17 janar 2017, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së mbajti seancën dëgjimore dhe i dëgjoji palët ndërgjyqëse në lidhje me çështjen kontestuese.
20. Më 24 mars 2017, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së kërkoi nga Zyra e regjistrimit kadastral caktimin e një eksperti të gjeodezisë për të kryer një ekspertizë në lidhje me paluajtshmërinë kontestuese. Zyra në fjalë, më 5 prill 2017 kishte kërkuar nga DhPGjS-ja, sqarime shtesë në lidhje me objektin e ekspertizës.
21. Më 19 shtator 2017, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së njoftoi palët ndërgjyqëse për mbajtjen e një seance tjetër dëgjimore, e cila u realizua në mënyrë të rregullt më 19 tetor 2017.
22. Më 9 nëntor 2017, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, përkitazi me këtë rast kishte mbajtur një seancë tjetër dëgjimore.
23. Më 19 dhjetor 2017, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, nëpërmjet Aktvendimit SCC-10-0353, hodhi poshtë, si të papranueshme, padinë e parashtruesve të kërkesës, për shkak se atyre u mungonte legjitimiteti aktiv në këtë procedurë kontestimore, sepse të njëjtit nuk provuan se janë pasardhës të S.S.D., duke arsyetuar se: *“AKP-ja në vazhdimësi ka deklaruar se pronari i pretenduar i pronës (dhe paraardhësi i pretenduar i paditësve), S.S.D., bazuar në deklaratat e paditësve e kishte fituar pronën, në bazë të një kontrate verbale me S. L., dhe ky akt juridik (nëse kishte ngjarë me të vërtetë) nuk mund që të njihej dhe nuk mund të krijonte ndonjë efekt juridik mbi pronësinë e pronës së kontestuar. Gjykatës nuk iu kishte dhënë mundësia nga ana e paditësve që të vendosë mbi meritat e rastit. Paditësit edhe pse gjykata u ka kërkuar vazhdimisht, nuk kanë ofruar ndonjë provë mbi lidhjen në mes të paditësve dhe pronarit të mirëfilltë të supozuar të pronës së kontestuar të tokës (me emrin Dragidella). Në këtë mënyrë paditësit nuk kanë mundur që të konfirmojnë para gjykatës të drejtën e tyre të legjitimitetit aktiv në pronësinë e kontestuar të parcelës 1743 me sipërfaqe prej 1.90,03 ha, e vendosur në vendim e quajtur Veternik në Prishtinë, të të ndjerit S.S.D. Nuk ka asnjë copëz të dëshmive të cilat do e dëshmonin të drejtën e paditësve Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku të jenë pasardhësit e të ndjerit S.S.D., [...]. Përgjatë seancave dëgjimore paditësit kanë dorëzuar në gjykatë shumë dokumente të cilat pas një shqyrtimi të hollësishëm të gjykatës ishte qartësuar se po këto dokumente kishin të bëjnë në fakt me një pronë tjetër, konkretisht parcelën e tokës nr. 2122, që ka ndonjë lidhje me parcelën e kërkuar me nr. 1743”*.

24. Më 19 janar 2018, parashtruesit e kërkesës ushtruan të drejtën e ankesës në Kolegjin e Apelit të DhPGjS-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkeljes së Ligjit nr. 04/L-033 për DhPGjS-në, me propozimin që Kolegji i Apelit të DhPGjS-së, të aprovojë padinë e tyre, të anulojë Aktvendimin e 19 dhjetorit 2017 dhe të kthejë çështjen në rivendosje në Kolegjin e Specializuar të DhPGjS-së, si dhe të vendosë masë sigurie në lidhje me paluajtshmërinë kontestuese.
25. Në ndërkohë, në nëntor të vitit 2020, parashtruesit e kërkesës theksojnë se janë vënë në dijeni, që e drejta e pronësisë i është njohur një personi tjetër dhe se këtë fakt e kanë kuptuar nga personi të cilit ia kishin shitur 0.12, ha, nga paluajtshmëria nr. 1743. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se më pas kishin kuptuar se DhPGjS-ja, të drejtën e pronësisë, përkritazi me paluajtshmërinë kontestuese nr. 1743, ia kishte njohur Z. H., me Aktgjykimin C-II-14-0140-C001, të 14 shtatorit 2015, sipas padisë së ushtruar më 9 dhjetor 2014.
26. Më 13 nëntor 2020, parashtruesit e kërkesës kërkuan në Gjykatën Themelore në Prishtinë vendosjen e masës së sigurisë kundër Y. H., përkatësisht të birit të trashëgimlënës Z. H., për të parandaluar tjetërsimin, fshehjen, ngarkimin apo deponimin me paluajtshmërinë lëndore nr. 1743, në vendin e quajtur "Veternik" në Prishtinë.
27. Më 14 janar 2021, Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesve të kërkesës, nëpërmjet Aktvendimit [Ac-I-18-0026], e refuzoi ankesën e tyre, ndryshoi *ex officio* Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, të 19 dhjetorit 2019, duke e refuzuar në tërësi, si të pabazuar, padinë e parashtruesve të kërkesës, përfshi edhe kërkesën për vendosjen e masës së sigurisë. Në arsyetimin e aktvendimit të tij, Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, arsyetoi: *"Ankesa e paditësve kundër Aktvendimit të ankimuar duhet të refuzohet si e pabazuar. Kolegji i Apelit vëren se pas shqyrtimit të gjithanshëm të dosjes, paditësit nuk kanë arritur të sjellin në gjykatë titull të vlefshëm pronësorë, në bazë të të cilit ata do të mund të pretendonin të drejtën e pronësisë në ngastrën e kontestuar. Tutje, Kolegji i Apelit vëren se lidhur me patundshmërinë, ngastrën kadastrale nr. 1743, vendi i quajtur Veternik, Kolegji i Apelit tashmë kishte vendosur me Aktgjykimin e vetë, AC-I-15-0212, të datës 22 gusht 2019, me të cilin Aktgjykim ishte refuzuar ankesa e AKP-së dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar C-II-14-0140, i cili e njohu të drejtën e pronësisë paditëses Z. (Rr) H., ndaj patundshmërisë, ngastra kadastrale nr. 1743, vendi i quajtur Veternik. Aktgjykimi tashmë, në bazë të nenit 9.14 të LDHP-së është i plotfuqishëm. Për më tepër nga përgjigja e Drejtorisë së kadastrit të Komunës së Prishtinës të datës 17/12/2020, konstatohet se transformimet kadastrale, në pajtim me Aktgjykimin e cekur të Kolegjit të Apelit ishin bërë që në janar të vitit 2020"*.
28. Më 19 nëntor 2021, Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Prishtinës, me kërkesë të Gjykatës ka dorëzuar informata dhe dokumente shtesë në lidhje me paluajtshmërinë nr. 1743, në sipërfaqe prej 28829 m2, duke njoftuar Gjykatën se në të dhënat elektronike që posedon kjo zyrë, rezulton se pas vitit 1999, paluajtshmëria nr. 1743 ishte regjistruar në emër të Pik Kosova Export, ndërsa para vitit 1999, kjo zyrë nuk ka të dhëna, ngase ato

gjenden në Serbi. Tutje, zyra njofton Gjykatën se në bazë të Aktgjykimit [C-II14-0140-C0001] të DhPGjS-së, të 22 gushtit 2019, pronësia mbi paluajtshmërinë në fjalë, më 13 janar 2020, ka kaluar në emër të Z. H. dhe më 5 tetor 2020, në emër të Y. H. (i biri), bazuar në noterizimin e vendimit të trashëgimisë. Me kërkesë të parashtruesve të kërkesës, Zyra kadastrale kishte vendosur vërejtje në paluajtshmërinë nr. 1743, bazuar në kallëzimin penal të 27 tetorit 2020 dhe kërkesën për masë të përkohshme të 28 tetorit 2020. Kjo vërejtje më pas është fshirë, më 10 dhjetor 2020, me kërkesë të avokatit të Y. H. Zyra kadastrale njofton Gjykatën se paluajtshmëria nr. 1743, deri më 3 nëntor 2021 është parcelizuar në 49 ngastra tjera, duke filluar nga ngastra nr. 1743-1, deri tek ngastra nr. 1743-49, për të cilat janë dorëzuar në Gjykatë certifikatat e pronësisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kolegjet e DhPGjS-së kanë shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNJ-së, si dhe nenin 7 [Barazia para ligjit] të DUDNJ-së.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktvendimin e kontestuar u është mohuar “barazia e armëve” në procedurë gjyqësore, sepse Kolegji i Apelit i DhPGjS-së nuk kishte mbajtur seancë kryesore për të mundësuar evitimin e paqartësive. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“kanë tentuar disa herë me shkresa të tregojnë se prona është e tyre dhe t’i ipet mundësia për gjykim publik, por një gjë e tillë i është mohuar nga Gjykata me arsyetimin se tashmë Gjykata në një proces tjetër ka vendosur mbi meritat e padisë dhe se nuk është lëshuar fare në analizim të çështjes, ndërsa vlen të theksohet se Kolegji i Specializuar... që nga viti 2010 kishte lëndën e kërkuësve në procedurë, por edhe pasi kishte vendosur mbi meritat e padisë ndaj një personi tjetër, kishte mbajtur seanca me kërkuësit për ngastrën e njëjtë kadastrale, do të thotë se i njëjti Kolegj ka qenë në dijeni të plotë se është duke i shkelur të drejtat ushtruesve të kërkesës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të gjitha Konventave ndërkombëtare”.*
31. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se provat e çështjes nuk janë marrë në mënyrë ligjore, duke theksuar: *“Gjykata asnjëherë nuk i kishte dhënë mundësinë ushtruesve të kërkesës që të administrojnë provat e dorëzuara, të dëgjohen si palë në procedurë, të dëgjohen dëshmitarët e propozuar, që të njëjtit të zhvillonin procedurë gjyqësore dhe mbrojtje të barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.*
32. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së për çështje që lidhen me AKP-në, duke e parë se në lëndë kishte prova të mjaftueshme për të vërtetuar legjitimitetin aktiv të tyre, kishte ndryshuar Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së [SCC-10-0353]

të 19 dhjetorit 2017, me arsyetimin se: "Pasi që janë analizuar të gjitha pretendimet ankimore dhe të gjitha shkresat si prova në këtë lëndë, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa është e pabazuar, ndërsa Aktvendimi i ankimuar është dashur Ex-Officio të ndryshohet, pasi padia nuk mund të thuhet se është e papranueshme pasi që paditësit, kanë sjellur dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë legjitimitetin e tyre aktiv, dhe mbi këtë bazë nuk ishte e saktë hedhja poshtë e padisë si e papranueshme". Prandaj, në këtë kuptim, parashtruesit e kërkesës shtrojnë pyetjen nëse në këtë procedurë të zhvilluar gjyqësore janë respektuar kërkesat e nenit 6.1 të KEDNJ-së, përkatësisht e drejta për një proces të rregullt gjyqësor.

33. Si përmbledhje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: "... prej kur është parashtruar padia për vërtetimin e pronësisë ndaj paluajtshmërisë, ngastrës kadastrale nr. 1743 me dt.02.12.2010 e deri më tani, përfaqësuesja e autorizuar e kërkuësve ka vërejtur se shkelja e të drejtave të kërkuësve lidhet posaçërisht me mënyrën e trajtimit të provave në procedurën gjyqësore".
34. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata të: "pranojë këtë rast dhe të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku, të garantuara me nenin 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 8 (është menduar neni 7) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 6, paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe protokolleve të saj".

Pranueshmëria ë kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[...]

37. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-18-0026] të 14 janarit 2021 të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
39. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa

shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

41. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktvendimet e kontestuara të Kolegjit të DhPGjS-së, u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNj-së, si dhe nenin 7 [Barazia para Ligjit] të DUDNj-së.
42. Gjykata vëren se esenca e pretendimeve që ngërthen kjo kërkesë e parashtruesve të kërkesës, ka të bëjë kryesisht me: (i) cenimin e parimit të barazisë së armëve, dhe (ii) ligjshmërinë e marrjes së provave, të cilat si pretendime bien në fushëveprimin e të drejtës për gjykim të drejtë, përkatësisht ngrenë çështje të procesit të rregullt gjyqësor, të cilat i garanton neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së.
43. Andaj, në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

I. Vlerësimi i pretendimeve për shkelje të së drejtës për “gjykim të drejtë”

44. Gjykata në lidhje me këto pretendime i referohet paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.
[...]

45. Përveç kësaj, Gjykata rikujton gjithashtu përmbajtjen e paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, i cili përcakton:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]”.

i. Përkitazi me pretendimet për shkelje të parimit të “barazisë së armëve”

A. Parimet e përgjithshme

46. Fillimisht, Gjykata vë në pah se, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, neni 6 i KEDNj-së, detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtrësive, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj (shih, GjEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993, Seria A. nr. 254-B, f. 49, § 30). Një detyrim i tillë për gjykatat jetësohet, ndër të tjera, përmes zbatimit të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kuadër, GjEDNj ka nënvizuar se parimi i barazisë së armëve është element i qenësishëm i konceptit më të gjerë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe është ngushtësisht i lidhur me parimin e kontradiktoritetit procedural (shih rastin e GjEDNj-së *Regner kundër Republikës Çeke*, Aktgjykimi i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146).
47. Në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, të cilën e ka ndjekur me konsistencë edhe Gjykata, është theksuar në vazhdimësi se parimi i barazisë së armëve kërkon *“ekuilibër të drejtë midis palëve”*, ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme që të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në pozitë të pafavorshme, gjegjësisht disavantazh thelbësor kundruall palës kundërshtare (shih rastet e GjEDNj-së *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, kërkesa nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33, *Feldbrugge kundër Holandës*, Aktgjykimi i 7 korrikut 1987, paragrafi 44 rastet *Ofrer dhe Hopfinger kundër Austrisë*, nr. 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680 dhe 696, shih dhe referencat e tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140; shih po ashtu rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI52/12, parashtruese *Adije Iliri*, Aktgjykimi i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykimi i 20 marsit 2012, paragrafi 40).

48. Duke u mbështetur në praktikën e GjEDNj-së, parimi i barazisë së armëve është i rëndësishëm, e sidomos në çështjet penale dhe ky parim zbatohet në të gjitha fazat e gjykimit, duke përfshirë edhe procedurën sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet vendimit të GjEDNj-së, në rastin *Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 21510/03, të 31 majit 2007. Në këtë rast, një kompani që ishte palë kundërshtare në procedurë me parashtruesin e kërkesës, sikundër edhe prokurori publik, kishin paraqitur ankesë, përkatësisht “kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë” në Gjykatën Supreme, kundër një vendimi të gjykatës së shkallës më të ulët. Pala tjetër (parashtruesi i kërkesës) nuk ishte njoftuar lidhur me atë kërkesë. Sipas GjEDNj-së, ankesa dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë çoi në vendimin e Gjykatës Supreme i cili ishte tërësisht i pafavorshëm ndaj palës tjetër (parashtruesit të kërkesës). Rrjedhimisht, GjEDNj-ja konsideroi se dështimi procedural për të njoftuar palën tjetër (parashtruesin e kërkesës) e ka penguar atë nga pjesëmarrja në mënyrë efektive në procedurë para Gjykatës Supreme. GjEDNj, më tutje, theksoi se “*respektimi i të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 6.1 të Konventës, kërkon që parashtruesi të ketë mundësinë që të ketë njohuri dhe të mund të komentojë apelin e kompanisë dhe kërkesën [për mbrojtje të ligjshmërisë] të prokurorit publik*”.
49. GjEDNj ka theksuar në vazhdimësi se i takon asaj për të vendosur se a janë zhvilluar procedurat e kontestuara, si tërësi, në përputhje me Konventën, duke përfshirë edhe nenin 6 të saj. Në këtë sfond, sipas GjEDNj-së, neni 6.1. i Konventës i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e Gjykatës (shih, ngjashëm GjEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993; *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988).
50. Ndërsa, parimi i kontradiktoritetit procedural nënkupton që palët në procedurë duhet të kenë dijeni dhe mundësi të komentojnë dhe kundërshtojnë pretendimet dhe provat që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, *Brandstetter v. Austria*, nr. 11170/84, Aktgjykimi i 29 gushtit 1991; *Vermeulen kundër Belgjikës*, nr. 19075/91, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1996). Duke u referuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata thekson se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural janë të lidhur ngushtë dhe në shumë raste GjEDNj i ka trajtuar së bashku (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, *Rowe and Dawis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 18990/91; Aktgjykimi i vitit 2000, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27052/95, Aktgjykimi i vitit 2000; *Zahirović kundër Kroacisë*, nr. 58590/, Aktgjykimi i 25 korrikut 2013).
51. Qëllimi kryesor i respektimit të këtyre parimeve është zhvillimi i një ballafaqimi real dhe përmbajtësor ndërmjet palëve ndërgjyqëse i cili ndikon në pasqyrimin real të rrethanave faktike dhe dhënien e drejtësisë objektive nga gjykatat. GjEDNj ka theksuar disa herë se kërkesat e mësipërme duhet të respektohen jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shkallët e tjera të gjykimit (shih, ndër të tjera, GjEDNj, rastin *Alimena kundër Italisë*, vendimi i 19 shkurtit 1991).

B. Aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

52. Në lidhje me këtë pretendim konkret, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ua ka mohuar atyre të drejtën për barazi të armëve, sepse nuk kishte mbajtur seancë kryesore për të mundësuar evitimin e paqartësive, duke argumentuar se: *“... një gjë e tillë iu është mohuar nga Gjykata me arsyetimin se tashmë Gjykata në një proces tjetër ka vendosur mbi meritat e padisë dhe se nuk është lëshuar fare në analizim të çështjes”*.
53. Ajo çfarë është thelbësore për Gjykatën në rastin konkret është fakti nëse parashtruesit e kërkesës kanë pasur mundësi reale të paraqesin prova dhe dëshmi që i kanë konsideruar relevante për rastin e tyre, dhe nëse provat apo dëshmitë e tyre janë shqyrtuar në mënyrë të rregullt, veçanërisht nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, si instancë përfundimtare në këtë çështje kontestimore.
54. Në vazhdim, dhe në lidhje me këtë pretendim konkret, Gjykata i referohet pjesëve relevante të aktvendimit të kontestuar të Kolegji të Apelit të DhPGjS-së, dhe vëren se kjo instancë fillimisht kishte hequr dilemat përkitazi me legjitimitetin aktiv të parashtruesve të kërkesës, duke e ndryshuar *ex officio* Aktvendimin [SCC-10-0353] e Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, me arsyetimin se: *“paditësit kanë sjellë dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë legjitimitetin e tyre aktiv në procedurë, dhe mbi këtë bazë nuk ishte e saktë hedhja poshtë e padisë si e papranueshme”*.
55. Për më tepër, Gjykata rikujton se Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, para se të merrte vendim për çështjen, mes tjerash, kishte administruar edhe provat në lidhje me pronësinë, duke shtuar se: *“Përfaqësuesi i paditësit vazhdimisht ka deklaruar gjatë seancave dëgjimore, se prona e kërkuar, ka qenë një pjesë e blerjes së dakorduar në vitin 1938 nga paraardhësi i paditësve dhe pronarit të mirëfilltë L.S., por nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për ta mbështetur deklaratën, e tij, asnjë certifikatë pronësie apo ndonjë dokument tjetër mbi pronësinë e z. L. S. mbi pronën e pretenduar, dhe për më tepër asnjë kontratë të shitjes së nënshkruar në vitin 1938, për kalimin e pretenduar të kësaj pronësie nga z. S., tek paraardhësi i tyre”*.
56. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese nr. 1743, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, ndër të tjera, arsyetoi: *“... pas shqyrtimit të gjithanshëm të dosjes, paditësit nuk kanë arritur të sjellin në gjykatë titull të vlefshëm pronësorë, në bazë të të cilit ata do të mund të pretendonin të drejtën e pronësisë në ngastrën e kontestuar”*. Në këtë kuptim, Gjykata vë në pah se, përveç çështjes së legjitimitetit aktiv, si kriter parësor i cili kërkohet të përmbushet nga palët që pretendojnë të jenë pasardhës (trashëgimtarë) të paraardhëseve të tyre, sikundër dhe pronarë të pronave të trashëguara, Kolegji i Apelit ka administruar në tërësi shkresat e lëndës, duke përfshirë edhe provat e dorëzuara pranë Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, në seancat publike të 17 janarit, 19 tetorit dhe 9 nëntorit 2017, ku vërehet qartë se palët ndërgjyqëse janë ftuar në mënyrë të rregullt për t'i ballafaquar provat dhe argumentet, kundruall njëra-tjetrës, për sa i përket titullit të pronësisë, mbi paluajtshmërinë kontestuese.

57. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i parashtruesve të kërkesës së Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, në rastin e tyre ka shkelur parimin e barazisë së armëve, për faktin se nuk kishte mbajtur seancë kryesore dhe se nuk është lëshuar fare në analizim të çështjes, sepse nga arsyetimi i aktvendimit të kontestuar vërehet qartë se kolegji në fjalë, ka marrë parasysh dhe ka shqyrtuar në tërësi të gjitha shkresat e lëndës (dosjen), përfshi provat përkitazi me legjitimitetin e palëve në procedurë dhe posaçërisht provat përkitazi me vërtetimin e titullit pronësor mbi paluajtshmërinë kontestuese, duke arritur në konstatimin se parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të sjellin titull të vlefshëm pronësor, përkitazi me paluajtshmërinë kontestuese.
58. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se përveç se është respektuar parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit procedural nga kjo instancë gjyqësore është respektuar po ashtu edhe parimi i palës së dëgjuar, pasi që Kolegji i Apelit i DhPGjS-së nuk kishte marrë vendim për çështjen, para se t'ua jepte palëve ndërgjyqëse mundësinë për t'i ballafaquar argumentet, provat dhe dëshmitë e tyre, kundruall njëra-tjetrës, që ato i konsideronin relevante dhe të favorshme për to, ashtu siç kërkon parimi i barazisë së armëve, si element i të drejtës për gjykim të drejtë, i garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.
59. Gjykata gjithashtu e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së nuk është drejtësi *substanciale*, por drejtësi *procedurale*. Në rrafshin praktik, koncepti i drejtësisë procedurale nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastin e Gjykatës KI22/19, me parashtrues: *Sabit Ilazi*, Aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 dhe rastet e cituara aty).
60. Andaj, nga të gjitha shtjellimet e mësipërme dhe bazuar në parimet e përgjithshme mbi të drejtën për barazi të armëve dhe të kontradiktoritetit procedural, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe se atyre u është dhënë mundësia e ballafaqimit të dëshmimeve dhe provave gjatë zhvillimit të procedurës pranë Kolegjit të DhPGjS-së. Por, duket se të njëjtit thjeshtë nuk janë pajtuar me rezultatin e procedurës dhe të gjykimit të çështjes së tyre nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së. Megjithatë, pakënaqësia e tyre nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj (shih rastin e GjEDNj-së, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
61. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për shkelje të parimit të barazisë së armëve, i garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-se, i përket kategorisë së (iii) të

pretendimeve të “pambështetura dhe të pajustificuara”, andaj, në baza kushtetuese, i njëjti duhet të shpallet qartazi i pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

ii. Përkitazi me ligjshmërinë e marrjes së provave

A. Parimet e përgjithshme

62. Përkitazi me ligjshmërinë e marrjes së provës, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së GJEDNj-së e cila, në parim ka theksuar se “[ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provës, si të tillë, një fushë kjo cila në radhë të parë i përkiste të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare” (shih, rastet e GJEDNj-së *Schenk kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46 dhe *Heglas kundër Republikës Çeke*, Aktgjykimi i 1 marsit 2007, paragrafi 84). Aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 102; shih gjithashtu rastin e GJEDNj-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 12 majit 2000, paragrafi 34; *P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 5 nëntorit 2002, paragrafi 42).
63. Në këtë kontekst, për të vlerësuar nëse procedura në tërësinë e saj, ka qenë e drejtë, rëndësi duhet t’i kushtohet nëse të drejtat e mbrojtjes janë respektuar. Pra, në këtë kontekst, duhet të vlerësohet nëse veçanërisht parashtruesve të kërkesës u është dhënë mundësia e kundërshtimit të provave kundër tyre. Për më tepër, kualiteti i provave duhet të merret parasysh, duke përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë këto prova, dhe nëse kjo paraqet dyshim sa i përket besueshmërisë dhe saktësisë së tyre. Përderisa nuk mund të thuhet që mund të vjen në shprehje domosdoshmërisht çështja e një gjykimi të drejtë kur prova e marrë është e mbështetur me materiale të tjera, duhet të theksohet se kur prova është shumë e fortë, dhe nuk ka rrezik që një provë e tillë të jetë e pabesueshme, atëherë nevoja për prova mbështetëse është më e vogël (shih rastet e GJEDNj-së *Boykov kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 90; *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 35 dhe 37; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 43). Andaj, për të konstatuar nëse në një rast të caktuar mund të ketë shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, është e rëndësishme thelbësore për konstatimin nëse prova e marrë në mënyrë të paligjshme, ka qenë provë e vetme dhe vendimtare lidhur me rastin konkret.

B. Aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

64. Në aplikimin e këtyre parimeve në rrethant e rastit konkret, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesve të kërkesës, përkitazi me ligjshmërinë e marrjes së provave, të cilët theksojnë se: “Gjykata asnjëherë nuk i kishte dhënë mundësinë ushtruesve të kërkesës që të administrojnë provat e dorëzuara, të dëgjohen si palë në procedurë, të dëgjohen dëshmitarët e propozuar, që të njëjtit të zhvillojnë procedurë gjyqësore dhe mbrojtje të barabartë e të

drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

65. Për më tepër, Gjykata rikujton pohimin e parashtruesve të kërkesës, ku theksojnë se: “... prej kur është parashtruar padia për vërtetimin e pronësisë ndaj paluajtshmërisë, ngastrës kadastrale nr. 1743 me dt.02.12.2010, e deri më tani, përfaqësuesja e autorizuar e kërkuësve (parashtruesve të kërkesës) ka vërejtur se shkelja e të drejtave të kërkuësve (parashtruesve të kërkesës) lidhet posaçërisht **me mënyrën e trajtimit të provave në procedurën gjyqësore”.**
66. Gjykta, sa i përket këtij pretendimi, duke vlerësuar natyrën e rastit, thekson se barra e provës në rrethant e rastit konkret i ka takuar parashtruesve të kërkesës (si palë paditëse) për të paraqitur dhe sjellur dëshmi dhe prova bindëse, që do e mbështesnin në mënyrë të pakontestuar pretendimin e tyre se palauajtshmëria kontestuese, përkatësisht ngastra me numër 1743, e ndodhur në zonën kadastrale të quajtur “Veternik” në Prishtinë, u takonte atyre.
67. Gjykata rikujton se është përtej juridiksionit të saj si Gjykatë Kushtetuese, të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave të rregullta, lidhur me vlerësimin e provave, përveç nëse ato janë marrë në mënyrë haptazi arbitrare. Gjykata Kushtetuese, bazuar në juridiksionin e saj nuk ndërhyn as në mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë pranuar provat si material dëshmuës dhe as në diskrecionin e tyre përkitazi me vlerësimin e vlerës dëshmuës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNj-së, *Doorson kundër Holandës*, paragrafi 78). Ajo çfarë është e rëndësishme në lidhje me çështjen e provave është vlerësimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese, nëse parashtruesit e kërkesës në mënyrë efektive kanë mundur t'i kundërshtojnë provat dhe dëshmitë kundër tyre, në këtë çështje kontestimore pronësore.
68. Në këtë drejtim, Gjykata rikonfirmon konstatimin e mësipërm se parashtruesit e kërkesës kanë pasur mundësi që pranë DhPGJS-së të paraqesin provat të cilat i kanë konsideruar të rëndësishme për çështjen e tyre, po ashtu atyre u është dhënë mundësia për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive provat kundër tyre. Në këtë kuptim, Gjykata, shikuar objektivisht shkresat e lëndës, konsideron se të gjitha dëshmitë e dorëzuara pranë DhPGJS-së nga parashtruesit e kërkesës janë shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga Kolegji i Apelit, para se të arrihej në konkluzionin përfundimtar, i cili ka rezultuar të jetë i pafavorshëm për parashtruesit e kërkesës.
69. Për më tepër, shikuar në tërësinë e saj procedura e zhvilluar pranë këtyre instancave gjyqësore nuk ishte e padrejtë dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GjEDNj-së së 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues: *Sabit Ilazi*, aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, paragrafi 58).
70. Andaj, Gjykata, në dritën e shqyrtimeve dhe arsyetimeve të lartcekura, si dhe duke marrë parasysh parimet e përgjithshme përkitazi me ligjshmërinë e marrjes së provave, në këtë procedurë kontestimore, konstaton se në rastin konkret, Kolegji i Apelit i DhPGJS-së nuk ua ka mohuar parashtruesve të

kërkesës të drejtën për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, në lidhje me këtë pretendim konkret.

71. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me ligjshmërinë e marrjes së provave i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

II. Sa i përket pretendimeve të tjera për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare

72. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës vetëm përmendin nenet 24, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 7 të DUDNj-së, megjithatë ata nuk shtjellojnë tutje, se si dhe pse ka ardhur deri të shkelja e këtyre neneve specifike. Gjykata përsërit se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
73. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, mjeteve efektive juridike dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

74. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se:
- i. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, në lidhje me barazinë e armëve dhe ligjshmërinë e marrjes së provave i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (b) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
 - ii. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, mjeteve efektive juridike dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, po ashtu i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë nën (a) (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, edhe këto pretendime duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

75. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 3 mars 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljajfi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Lisa Caka-Nimani